



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/ Nr. 4483/2019

Data: 22.05.2019

### PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e katërt - IV- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 25.04.2019 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrotjtje të Mjedisit), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Sevime Laçi (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), Medina Imishti (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Ajete Berisha (Udhëheqëse e Personelit), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Betime Bushi (Praktikante në Komunë), Përfaqësuesit e OSB-së. Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnje anëtarë i kuvendit të komunës.

#### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Mars 2019.
3. Miratimi i kërkesës për dhënien e pëlqimit për sh.p.k "Elkon" Prishtinë.
4. Miratimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për "Javën Kulturore" 2019.
5. Informatë për ndarjen e bursave.
6. Miratimi i nismës për bashkëpunim ndër komunal me komunën e Kaçanikut.
7. Miratimi i propozim vendimit për ndarje të parcelës për ndërtimin e qendrës kulturore në Han të Elezit.
8. Informatë mbi raportin finansiar për tre mujorin e N.P.L "Pastrimi" Sh.a.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me rendin e punës hapi diskutimin.

**Mefail Suma** thekson:- në mbledhjen e fundit u përmend që opozita është këtu vetëm për me kritikuar dhe ne të rrjedhë edhe sot ashtu, mirëpo nuk kam qëllim me kritikuar por propozoj që si pikë e rendit të punës me u diskutuar në mbledhjen e ardhshme të kuvendit të komunës. Kjo pikë sipas propozimit tim do të ishte nepotizmi familjarë dhe politik në komunë.

**Kryesuesi** thekson:- këtë pikë që potencove nuk e marr përgjegjësinë që të hyn si pikë për mbledhje të radhës por secili e ka pozicionin e vetë dhe nuk e marr këtë përgjegjësi.

**Mefail Suma** thekson:-parashtrova këtë propozim që zakonisht pikat e rendit të ditës kur propozohen apo ndryshohen nuk po realizohen prej propozuesit por unë nuk po shkoj me atë qëllim që nuk do të miratohet ky propozim sepse aty për aty me propozuar nuk jemi të përgatitur edhe ne që po e propozojmë dhe nuk e besoj që jeni të përgatitur edhe ju, mirëpo nuk prishë punë nëse mbetet për mbledhje të ardhshme të kuvendit të komunës për shkak se përgatitemi edhe për debat.

**Kryesuesi thekson:-** mënyra e propozimit të pikave ju e dini se si parashihet me Ligj të Vetëqeverisjes Lokale sepse për me miratuar këtë pikë të rendit të punës duhet të loboni te grupet parlamentare dhe në momentin që sigurohen votat mund të diskutohet si pikë e rendit të punës.

**Florim Shkreta thekson:-** unë nuk mendoj që është pikë që nuk ja vlen të hyjë në rend të punës dhe besoj që edhe tash është mirë me proceduar.

**Mefail Suma thekson:-** nëse nuk miratohet ky propozim sipas meje po rrjedh që po frigoheni.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** pikën e rendit të punës të ndryshme a e keni përcaktuar të veçantë a përfshihen edhe pyetjet dhe përgjigjet. Te pika e rendit të punës të ndryshme ka material edhe ide me diskutuar edhe për propozimin që e parashtroj z. Mefail Suma. Si pikë e veçantë për nepotizmin është fushë shumë e gjërë dhe mund të diskutojë secili në botëkuptimin e vetë.

**Kryesuesi thekson:-** te pika e rendit të punës të ndryshme të drejtë ka secili me diskutuar për ndonjë temë.

**Nuriman Kuka thekson:-** për mos me ikur prej rendit punës atë që e potencoij z. Mefail Suma nuk jam kundër asgjë por duhet të bëhen përgatitjet më herët sepse është një pikë që donë rëndësi. Si grup parlamentarë mendoj që të jetë për mbledhjen e radhës por mënyra se si do të procedohet është komiteti dhe komisionet e tjera. Për këtë mbledhje nuk jam që të diskutohet.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri, (prezent ishin 15 anëtarë të kuvendit të komunës).

#### U MIRATUA RENDI I PUNËS

##### **1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 15 anëtarë të kuvendit të komunës).

#### MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

##### **2. Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Mars 2019.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Rufki Suma thekson:-** Drejtori për Buxhet dhe Financa nuk ka mundur të jetë prezent në mbledhje për shkak të problemeve shëndetësore. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mefail Suma thekson:-** më herët është paguar edhe përvoja e punës për çdo vit 0.5% dhe a ju paguhet punëtorëve komunal përvoja e punës.

**Rufki Suma thekson:-** shuma e mjeteve financiare prej 4000 € është pikërisht pagesa e përvojës së punës.

**Hanumshahe Dibrani thekson:-** tabela numër pesë kodi 13480 shpenzimet për anëtarësim kërkoi sqarim për shkak se vitin e kaluar është paguar shuma prej 940 €, ndërsa në këtë vit nuk është paguar.

**Florim Shkreta thekson:-** pse nuk është kryer pagesa për të cilën z.Hanumshahe Dibrani kërkoi sqarim?

**Rufki Suma thekson:-** kjo pagesë mund të jetë te asociacioni i komunave për anëtarësim për shkak se në këtë vit nuk është paguar ende. Kjo është taksë dhe kemi obligim por kemi kohë me paguar, mirëpo ata të cilët duan me paguar mund ta kryejnë pagesën në muajin janar dhe nuk e presin afatin. Vitin e kaluar buxheti është miratuar më herët dhe i kemi kryer të gjitha borxhet të cilat i kemi pasur por edhe kjo do të kryhet.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 15 anëtarë të kuvendit të komunës).

#### U MIRATUA RAPORTI I SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR-MARS 2019

### 3.Miratimi i kërkesës për dhënien e pëlgjimit për sh.p.k “Elkon” Prishtinë.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- kompania në fjalë ka parashtruar kërkesë komunës për dhënie të pëlgjimit për hulumtim të potencialit të lumenit Lepenc me mundësi të ndërtimit të një apo dy hidrocentraleve të vogla. Këto janë hidrocentrale të vogla me kapacitet përfundimtë 100 amvisërise me energji elektrike. Janë projekte interesante dhe miqësore me ambientin të cilat nuk shkaktojnë dëmtime në mjedis, përkundrazi kanë efekte pozitive sepse bëhet mirëmbajtja e rrëthit aty ku bëhet ndërtimi. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- para se me filluar me diskutime të tjera ftoj përfaqësuesin e kompanisë që ta elaborojë kërkesën që e ka parashtruar.

Përfaqësuesi i Kompanisë “Elkon” thekson:- siç e dini edhe ju, ministria i ka suspenduar përkohësisht ndërtimin e hidrocentraleve të cilat janë me tubacion për shkak se po bëhet degradimi i ambientit. Përvojën e kemi me kompaninë Austriake për shkak se në dy lokacione kanë bërë ndërtim. Si kompani zotohemi me bërë një projekt i cili do të jetë në të mirën e komunës dhe me rregulluar shtratin e lumenit Lepenc në atë pjesë ku do të ndërtoj ashtu siç e keni të paraparë në planin urbanistik dhe me bërë ndiqmin përfundimtë të lumenit Lepenc, me ndërtuar edhe ndonjë fushë të vogël të futbollit. Si investime ne mendojmë mi bërë dy kaskada dhe si investim është 500 000 € deri në 600 000 € dhe kapaciteti është 300 kilovatë rrymë. Pasi do të përfundojnë punimet kompania mund t'i punësoj tre apo katër punëtorë. Ky projekt është i dobishëm edhe për komunën edhe për kompaninë por do të jetë shembull edhe për Kosovë.

Mehmet Ballazhi thekson:- prodhim prej 300 kilovatë rrymë mendoj që është i ulët për një kaskadë dhe nëse ndërtohen dy do të janë 600 kilovatë dhe nuk e leverdisë prodhimin me atë që ka me ju kthyer komunës me një formë të bashkëpunimit.

Sabrije Krasniçi thekson:- a keni filluar me bërë këtë projekt me ndonjë komunë tjetër apo vendi i parë është në Han të Elezit?

Florim Shkreta thekson:- sa do të jetë afati i ndërtimit dhe a e keni përzgjedhur lokacionin por ju keni dhënë premtimet se çka do të ndërtoni në Han të Elezit dhe vetë këtë investim do ta realizoni. Investorët të cilët kanë shprehur gatishmëri me investuar në komunën e Hanit të Elezit i kemi respektuar por duhet edhe reciprociteti ndaj jush, mirëpo është një problem se kur po fillojnë punësimet do të jetë problem se kryetarit i kanë mbetur edhe disa pa i punësuar. Anëtarët e kuvendit kanë dhënë votën për atë kompani dhe ende pa e marr veten mirë kompania i gjuhet për punësimin e personave të ndryshëm dhe është mirë me premtuar që me i punësuar personat të cilët e meritojnë.

Përfaqësuesi i Kompanisë “Elkon” thekson:- në kilovatë fiton kompania dhe sistemi, kurse komuna përfiton në ambient dhe në punë. Vendi i parë i ndërtimit është në Han të Elezit por në material keni parë modelin që është ndërtuar në Austri sepse është projekt miqësorë me ambientin dhe nuk ka ndonjë pengesë ambientale. Investimet që do të janë në bazë të planit urbanistik në atë pjesë nuk keni nevojë me i realizuar sepse i realizojmë na vetë dhe do të jetë një kursim përfundimtë i madh. Në momentin që do të merret leja e ndërtimit dhe licenca prej rregulatorit afati i ndërtimit është një vit. Ne mund të bëjmë marrëveshje përfundimtë i gjitha çështje dhe ne i mbajmë zotimet.

**Mefail Suma** thekson:- si do të duket mënyra e akumulimit të ujit? Sa do të jetë thellësia? A do të jetë nën rrrethojë ai vend? Si do të bëhet forma e shpërndarjes së energjisë? Sa do te ketë sipërfaqe uji ku akumulohet?

**Nora Xhoni** thekson:- premtove ndriçim , premtove punësim mirëpo a do të shkakton ndonjë lloj zhurme?

**Akif Shkreta** thekson:- nga e kaluar kemi dhënë pëlqime të tilla të shumta por nuk është bërë ndonjë hap në këtë drejtim të hidrocentraleve dhe pëlqimet të cilat i kemi dhënë për minierat dhe rrjedhimisht rrjedh pyetja se sa kanë afat ligjor këto pëlqime. Ne japim pëlqime por po keqpërdoren në forma të ndryshme. A do të ndikon në dëmtimin e florës dhe faunës dhe pse projekt ka një afat një vjeçar për me i filluar punimet? Nga ky projekt po e shohë një rrezik sepse aty po krijohet një gjiri që mund të krijohet ndonjë vend ku mund të freskohen fëmijët, mirëpo duhet të merren masa preventive për çështjen e thellësisë.

**Nuriman Kuka** thekson:- saktësisht ku do të ndërtohet objekti?

**Isni Bushi** thekson:- a do t'i pengon peshqit të cilët janë në lumin Lepenc?

**Përfaqësuesi i Kompanisë “Elkon”** thekson:- energjia e cila prodhohet do të shpërndahet në rrjet dhe do të shkon ka është shpenzimi. Nuk mund të bëhet thelli ajo për shkak se vërshon dhe duhet të bëhen studime të sakta po nuk guxojmë shumë se dy apo dy metra e gjysmë . Ne mundemi me vendos rrrethojë por ndoshta e humbë bukurinë sepse nuk është punë e lehtë por nuk është e nevojshme për shkak se nuk është thelli e madhe. Sipërfaqe të madhe nuk do të ketë. Zhurmë nuk do të ketë. Afati është një vit prej momentit ku do të merret pëlqimi dhe kur do të rregullohen dokumentacionet. Sa i përket thellësisë gjatë hartimit të projekteve mund ta marrim ndonjë hap në bashkëpunim me komunën. Vendi për ndërtimin e këtij objekti do të jetë te kafiteria që është afër lumit Lepenc dhe njëra mendohet të ndërtohet te Ura e Fezës. Jo nuk do të jetë pengesë për peshqit.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- asnjë përfaqësues të ndonjë kompanie për çështje të ndryshme nuk e kemi penguar por ju është dhënë pëlqimi. Më herët ka pasur kompani të cilat kanë marr pëlqime dhe kanë neglizhuar. Në bazë të dokumentacioneve dhe sqarimeve që u dhanë nuk ka ndonjë pasojë Hani i Elezit prej kësaj por normalisht që ka përfitime nëse marrëveshja përbahet. Marrëveshjet kur të bëhen duhet të bëhen në mënyrë të sinqertë dhe të bëhen në mënyrë profesionale.

**Akif Shkreta** thekson:- është mirë të rishqyrtohen të gjitha pëlqimet që janë dhënë se është e rregulluar me ligj kjo çështje sepse nëse është dhënë pëlqimi para tri vite dhe vetëm është usurpuar ajo pjesë është mirë të shikohet.

**Nexhmedin Daci** thekson:- dy kompanitë të cilat i kanë marr pëlqimet i kanë edhe lejet ndërtimore por njëra ka pas problem për shkak të punimeve të kompanisë “Bektelenka” dhe komisioni rregullativ i energjisë ja ka zgjatur afatin edhe për një vit . Me kompaninë në fjalë nuk kemi nevojë me bërë marrëveshje por japim vetëm një pëlqim në parim dhe dokumentet e tjera do t'i rregullon përmes ministrisë dhe pastaj duhet të aplikon për leje ndërtimore në komunë.

**Akif Shkreta** thekson:-pëlqimet nuk bëhet fjalë vetëm për hidrocentrale por kemi dhënë pëlqime edhe për ekspluatim të gurit dhe nuk kanë filluar punimet.

**Nexhmedin Daci** thekson:-kompanitë në momentin që e marrin pëlqimin prej komisionit për miniera dhe minerale dhe afatin për fillim të punimeve e kanë një vit.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 14 anëtarë të kuvendit të komunës).

**U MIRATUA KËRKESA PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR SH.P.L “ELKON” PRISHTINË**

#### **4. Miratimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për "Javën Kulturore" 2019.**

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Menduh Vlashi** thekson:- për çdo vit kemi bërë propozim vendim për shpenzimet për "Javën Kulturore" por në këtë vit e kam analizuar më mirë dhe në KPF e bissem që me një mënyrë u pajtuam që është i pa nevojshëm propozim vendimi për shkak se buxheti miratohet në shtator. Në këtë vit ka arsyesh për shkak se e kemi shtuar shumën e mjeteve sepse po planifikojmë shpenzime më të mëdha për shkak të 20 vjetorit të rënies së dëshmorëve. Jemi munduar në detaile me i përshkruar të gjitha aktivitetet që do të mbahen për dallim që nga viti i kaluar ishin për javën kulturore, mirëpo realisht nuk duhet të quhet javë kulturore sepse janë dhjetë ditë që do të ketë aktivitetet. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- është më mirë kur përcaktohet një plan për zhvillimet kulturore gjatë gjithë vitit sepse për atë bëhen planet vjetore. Mjetet që ndahanë në këtë mënyrë për javën kulturore dalin jo serioze sepse për çdo aktivitet kulturorë duhet me bërë kërkesa dhe me i miratuar në kuvend për me i shpenzuar mjetet. Në planin vjetor dihen data që janë të përcaktuara dhe bëhet një paralogaritje e shpenzimeve për secilin aktivitet sepse nuk mund të dalim jashtë buxhetit të komunës që është i miratuar. Është mirë që në vitin e ardhshëm të veprohet sipas planit vjetorë.

**Akif Shkreta** thekson:- Hani i Elezit identifikohet sa i përket aktivitetet me mundjen dhe do të ishte mirë që të jetë pjesë e aktivitetet edhe një garë në mundje.

**Isni Bushi** thekson:- te fituesi që do të përzgjidhet te krosi, ndarja e çmimeve a do tu epen mjete financiare kesh apo si do të jetë forma.

**Menduh Vlashi** thekson:- aktivitetet sa i përket mundjes tjera vite nuk e kemi pasur, mirëpo do të bisedoj me kryetarin e klubit dhe brenda mundësive duhet të përfshihet. Sa i përket fituesit në kros do të shikojmë se a do të kemi mundësi pare kesh me i dhënë sepse është vështirë.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim , rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### **U MIRATUA PROPOZIM VENDIM PËR NDARJEN E MJETEVE FINACIARE PËR JAVËN KULTURORE 2019**

##### **5. Informatë për ndarjen e bursave.**

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Menduh Vlashi** thekson:- bursat janë ndarë në bazë të rregullores të cilën është miratuar në kuvendin e komunës. Në këtë vit e kemi rritur numrin e studentëve përfitim të bursës dhe janë ranguar në bazë të kritereve , mirëpo ka rënë numri i studentëve . Bursë kanë përfituar të gjithë dhe përvèç studentëve të viti të dytë të tretë, bursë kanë marr edhe studentët të cilët janë në vitin e parë. Rezultatet janë prezantuar para studentëve. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Florim Shkreta** thekson:- numri është rritë deri në 30 dhe këtu po shihet dy studentë të vitit të parë që janë përfitues por është mirë që tu jepni edhe studentëve të tjerë që janë në vitin e parë në mënyrë që të bëhet numri 30 bursa.

**Samire Curri** thekson:- falënderoj drejtorin për informatën të cilën na e ka sjellë dhe siç shihet të gjithë aplikuesit ishin përfitues të bursës. Është për tu përshëndetur rezultati i studentëve tanë në drejtimet deficitare dhe ju urojë suksese.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- është shqetësuese për shkak se bursat ndahen për 30 studentë , kurse aplikojnë vetëm 24 dhe është mirë që të gjendet shqetësimi se cilat janë ato mangësi që nuk kanë aplikuar të gjithë. Shqetësimi tjetër është se ne po i ndajmë bursa dhe studentët të cilët e kryejnë fakultetin që janë të stimuluar prej komunës janë rrugëve dhe punësimet që bëhen janë jo profesional. Komuna i stimulon dhe mbeten rrugëve , kurse marrin tjerë dhe i stimulojmë me kryer fakultetin brenda komunës dhe kjo është shqetësuese.

**Mefail Suma** thekson:- drejtori potencoj që në këtë vit numri ka qenë më i vogël i studentëve por më duket që është shqetësim dhe hendikep për arsyet se nëse nuk dihet se pse ka mbetur numri i aplikuesve më i vogël se i viteve të tjera , mendoj se informimi dhe shpallja e konkursit nuk është në rregull. Si komunë shpesh lëvdoheni që i keni administratorët e fshatrave dhe së paku duhet me i njofuar edhe studentët nëpër fshatra . Në fshatin Dimcë janë tre studentë dhe asnje nuk ka aplikuar sepse me siguri nuk e kanë ditur që jep komuna bursë. Hani i Elezit a vetëm dy studentë i ka të cilët janë të regjistruar në vitin e parë të cilët janë përfitues të bursës apo ka edhe të tjerë? Nuk është dashur komisioni me mbajt mbledhje dhe me i ndarë bursa pa u mbushur numri i aplikantëve sepse e shohë si gabim të madh për shkak se keni potencuar se keni mjete financiare për 30 bursa dhe është dashur të bëhen 30. Në një mbledhje të më hershme u diskutua për shumë dhe përcaktimin e kritereve për ndarjen e bursave u potencua fakulteti i aktrimit dhe në këtë mbledhje del që në këtë fakultet ka qenë dikush prej Hanit të Elezit që nuk prishë punë, mirëpo ne aktorë kemi në Han të Elezit dhe qe dhjetë vite është i pa punë sepse nuk ka kurfar aktiviteti në Han të Elezit dhe nuk ka ku me u punësuar dhe duhet të shkon në Prishtinë. A i ndani bursat në kokë të njerëzve apo aty ku duhet për me i ndarë sepse këtu shihet se po pozicionoi kah i forti e jo kah i drejti. Kjo është informatë dhe kisha kërkuar që mos të na informoni me kësi farë gjëra pasi që nuk kemi mundësi me u kyçur në to dhe me ndryshuar diçka. Nëse është mundësi të kthehet lista përsëri dhe të plotësohet dhe të bëhen 30 studentë. Është turp për komunën që mos me aplikuar studentët për me marr bursë dhe i bien që nuk e njehë komunë, mirëpo është e vërtet që nuk të njehë për shkak se e kryen fakultetin dhe mbetet rrugëve.

**Menduh Vlashi** thekson:-në konkurs e kemi precizuar që nëse nuk plotësohet lista me vitin e dytë e mbi do të merren parasysh studentët e vitit të parë dhe do të merret parasysh nota mesatare , suksesi i viteve të shkollës së mesme dhe suksesi i testit të maturës për rangim. Shpallja ka qenë publike në vebfaqe të komunës, në tabelën e shpalljeve , është shpërndarë edhe në fesbuk. Me aplikuar afat ka pasur 14 ditë dhe aq sa kanë aplikuar kanë përfituar bursë. Është fatkeqësi që nuk kemi studentë mjaftueshëm që me aplikuar por arsyet nuk i di dhe duhet me bërë një studim më të hollësishëm por unë kam bindje se ka rënë interesimi me u regjistruar në fakultet publik. Studentët të cilët po e kryejnë fakultetin dhe po mbisin rrugëve është dukuri, komuna jep bursë , por me i siguruar vend të punës është pak problem për shkak se është stimulim me kryer fakultetin. Informimi ka qenë shumë i rregullt dhe transparent si çdo vit. Studentët të cilët e kanë humbur vitin në bazë të rregullores nuk mund të përfitojnë bursë. U potencua se a ndani bursa për kokë të banorit por sikur të kishin mbetur pesë apo dhjetë studentë mund ta potenconi atë por kanë marr të gjithë që kanë aplikuar dhe nuk është arsy me potencuar këtë . U potencua që nuk është dashur me u ndarë bursat pa u bërë 30 aplikantë por në momentin që përfundon konkursi formohet komisioni dhe bëhet përzgjedhja e aplikantëve sepse kjo është rregull. Vendimin për caktimin e fakulteteve prioritare e ka bërë kuvendi i komunës sepse e përcakton rregullorja në këtë mënyrë.

**Mefail Suma** thekson:- rrjedhë që ndahet për kokë banorit sepse ju kujtohet mirë kur u miratua rregullorja dhe u diskutua se cilat fakultete janë më të favorshme dhe ju kujtohet kur e përmenda aktrimin dhe në Han të Elezit e nlohë një që e ka kryer qe dhjetë vite dhe tash është tu e kryer edhe një, mirëpo me siguri e ka dashur që e ka zgjedhur atë fakultet dhe për atë që mendoni që e ka përsëritur vitin unë them se mbesa ime të gjitha notat i ka të larta dhe nuk ka qenë e njofuar për me aplikuar për bursë. Ju potenconi që sistemi i informimit është mirë por unë mendojë që nuk është mirë sepse a mendoni që vetëm dy studentë janë regjistruar në universitet në vitin e parë por unë mendojë që janë më shumë dhe në komunë e keni mbush me studentë të cilët janë duke i kryer fakultetet në universitete private. Ju po i financoni studentët me studiuar në Universitetin e Prishtinës mirë në punësim përparësi kanë tjerët.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

## 6. Miratimi i nismës për bashkpunim ndër komunal me komunën e Kaçanikut.

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani thekson:-** neve nuk na ka munguar edhe më herët bashkpunimi me komunën e Kaçanikut por asnjëherë nuk kemi kërkuar që të marrim ndonjë vendim në kuvend. Që nga themelimi i komunës së Hanit të Elezit bashkpunimi me komunën e Kaçanikut asnjëherë nuk ka munguar. Qëllimi i kësaj nisme është se Ministria e Pushtetit Lokal ka një fond që është për bashkpunimin ndër komunal në mes dy komunave dhe mund të përfitojmë projektin nëse dy komuna bëhen bashkë në investimet e një projekti që është në interes të përbashkët. Si komunë e kemi parë të arsyeshme të konkurojmë në këto fonde dhe për këtë arsy duhet edhe pjesa formale që na të jemi konkurentë në këtë kërkesë. Te kjo pjesë kuvendi i komunës së Hanit të Elezit duhet ta miraton këtë nismë të bashkpunimit dhe kuvendi i komunës së Kaçanikut. Biseda kemi pasur me komunën e Kaçanikut dhe është e interesuar që kjo të kalon një procedurë formale. Projekti është për rrugën e cila e lidhë fshatin Gorancë me fshatin Kotlinë është strategjike dhe për atë i kemi dhënë prioritet.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** është mirë të bëhet një bashkpunim i përhershëm në projekte të ndryshme.

**Florim Shkreta thekson:-** a është llogaritur kostoja e atij projekti dhe pastaj mirëmbajtja e asaj rruge pasi të realizohet si projekt?

**Mallzum Qajani thekson:-** realisht mund të flasim që ajo rrugë nuk është shumë primare por ne në kuptim të bashkpunimit dhe në kuptim të realizimit të atij projekti nga ai fond që e ka Ministria e Pushtetit Lokal nuk mund të konkurojmë me projekte të tjera dhe mund të konkurojmë me projekt të përbashkët të dy komunat dhe njëra duhet të jetë bartëse e projektit dhe komuna tjetër duhet të jetë përkrahëse. Në rastin tonë ne e kemi një komunë bartëse dhe komuna e Kaçanikut është përkrahëse në realizmin e këtij projekti. Sa i përket mirëmbajtjes ne fillimisht po duam me hap si rrugë sepse komuna i ka burimet e ujit të Hanit të Elezit në Glloboçicë dhe kjo rrugë na afro deri te burimet e ujit. Mirëmbajtja bëhet për rrugët primare por nëse kemi mundësi financiare do ta mirëmbajmë edhe këtë rrugë. Me komunën e Kaçanikut edhe pse nuk kemi ndonjë marrëveshje me shkrim por kemi bërë shumë punë të përbashkëta.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim , rezultati i votimit ishte njëzëri.

## U MIRATUA NISMA PËR BASHKPUNIM NDËR KOMUNAL ME KOMUNËN E KAÇANIKUT

## 7. Miratimi i propozim vendimit për ndarje të parcelës për ndërtimin e qendrës kulturore në Han të Elezit.

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci thekson:-** për këtë projekt është e nevojshme që kuvendi me marr vendim për dedikimin e parcelës ku do të ndërtohet qendra kulturore në Han të Elezit. Ne jemi përcaktuar për parcelën se nëse bëhet ndërtimi do të bëhet te salsa ekzistuese por është pjesë e dokumentacionit të nevojshëm përvèç projektit kryesorë, matjet gjeomekanike dhe gjeodezike.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** është mirë të diskutohet se si do të duket shtëpia e kulturës dhe a do të ketë objekte të tjera përcjellëse dhe për çka do të shfrytëzohen ato e që do të ishte mirë që me ua prezantuar anëtarëve të kuvendit të komunës në mënyrë që do të ishte një transparencë më e madhe. Si grup parlamentarë do të votojmë për.

**Akif Shkreta thekson:-** unë dëshirojë që ajo qendër e cila do të realizohet të jetë e shfrytëzueshme qind për qind e jo si disa objekte. A është menduar që qendra kulturore me u vendosur diku tjetër?

**Mefail Suma thekson:-** më kujtohet para disa viteve në Kaçanik pasi u shtrojke asfalti pastaj pas një muaje u dëmtojke ai asfalt për rregullim të kanalizimeve dhe përsëri u shtrojke asfalti tjetër. Po më duket që komuna jonë nuk ka potencial njerëzorë që punon në këtë drejtim për dhënien e propozimeve për ndërtimin e objekteve. Këtë e them duke u bazuar se sa mjete janë shpenzuar për me u ndërtuar shtëpi ekzistuese e kulturës sepse u përmend se do të rrënohet. Këtu me një far mënyre të ngjashme do të rrënohen edhe objektet e tjera ndoshta, mirëpo është mirë me i analizuar çështjet. Unë mendoj se kur është ndërtuar banesa është ndërtuar shkel e shko dhe tash do të ndërtohet shtëpia e kulturës aty dhe ka qytetarë që banojnë aty dhe në shtëpi të kulturës do të ketë zhurmë pastaj sepse do të zhvillohen aktivitete kulturore dhe sportive. A keni menduar mirë se ku do të ndërtohet kjo shtëpi e kulturës dhe ndoshta do të ishte më mirë me u ndërtuar ish kazerma e TMK-së që tash shfrytëzohet nga Policia e Kosovës sepse është vendi pak më i qetë? Me një mbledhje të kaluar të kuvendit kam parashtruar pyetje se a ka ndonjë projekt komuna afatgjatë, afatmesëm te ish objektet të cilat i ka pasur ushtria. Me një mbledhje në mandatin e parë kur është formuar pilot njësi komunale janë përmendur 60 ari tokë dhe çka do të bëhet me atë tokë. Nuk e di a e ka komuna regjistrin e pasurisë së vetë dhe të ndërtesave por nuk po e kërkoj po nëse e ka ne të legjitimohen ato. Ju mendoni që po punoni por nuk është ashtu siç flitet sepse juve ju duket mirë dhe mendoni që opozita po flet që e ka për detyrë vetëm me folur por ne po duam me pa ndryshime. Unë dëshiroj që të ndërtohet një objekt i banimit dhe të ju ndahet familjeve skamnore por janë ndarë 1 040 000.00 € vetëm me shtruar kubëza dhe nëse nuk mundoni për një vit me ndërtuar mundet për dy apo tri vite për shkak se ka skamnorë dhe është mirë me ju ndarë banesa, mirëpo mendohet vetëm në kubëza me investuar.

**Mallzum Qajani thekson:-** projekti në fjalë është miratuar në kuvendin e komunës dhe nuk kemi menduar për ndonjë lokacion për shkak se kjo sallë është për nevoja themelore por për një aktivitet më të madh kulturore nuk kemi hapësirë. Do të jetë një sallë që do të ketë më shumë hapësirë dhe do të ketë salla për ushtrime, sallë për eksposítë dhe do të ketë pjesë administrative. Nuk kemi ndonjë projekt detal të cilin do ta prezantojmë para jush por si ide kjo është. Rrethi nuk do ta pengon se nuk është hallë sportit dhe nuk do të luhen lojë dhe mund të ketë aktivitete shoqëria kulturore artistike. Është e vërtetë se një pjesë e këtij objekti është ndërtuar pas luftës por me gjithë atë si projekt ka kaluar në kuvend dhe Ministria e Kulturës na ka ofruar një shumë të mijeteve dhe nëse dëshirojmë me i marr duhet të ecim me hapa pak më shpejtë. Vendimi që do të merret është formal për arsyen se parcela është e shtëpisë së kulturës. Projektin për shtrimin me kubëza betoni në zonën rurale dhe urbane është miratuar në kuvendin e komunës dhe mjetet financiare janë ndarë prej komunës.

**Mefail Suma thekson:-** kur them që nuk ka potencial për këtë po bazohem te ndërtimi i objekteve që janë bërë deri tash. U ndërtua ambulanca por edhe dhjetë vjet nuk ka me pasur zyre në ambulantë. Është ndërtuar ndërtesa e mirëqenies sociale dhe nuk ka zyre dhe është dashur me menduar për objektin që është ndërtuar që me pas zyre për pensionistë. Duhet të mendoni edhe për partitë politike sepse në të ardhme ndoshta do të rrënohet edhe ai objekt. Duhet të mendoni më kthjellët e jo vetëm të thuhet se është kryetari i mirë dhe të duartrokisni dhe me duartrokositje nuk ndërtohet asgjë.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim, rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJE TË PARCELËS PËR NDËRTIMIN E QENDRËS KULTURORE NË HAN TË ELEZIT

##### 8. Informatë mbi raportin finanziar për tre mujorin e N.P.L “Pastrimi” Sh.a.

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani thekson:-** kryesuesi i komisionit të aksionarëve është me një takim zyrtarë jashtë vendit dhe nëse keni ndonjë pyetje apo ndonjë sugjerim mund të parashtroni.

**Florim Shkreta thekson:-** në mbledhjen e kaluar këshilltari z.Sabedin Hasallari ka propozuar që personat të cilët janë dërguar në përmbarues privat me ua lehtësuar pagesën për një kohë sepse ju është bërë shumë pagesë. A ka ndërmarr kompania ndonjë veprim për këtë çështje?

**Sabedin Hasallari thekson:-** propozimin të cilin e kam parashtruar në mbledhjen e fundit të kuvendit të komunës a është shqyrtaur në bordin e ndërmarrjes?

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim , rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### **9. Të ndryshme.**

**Kryesuesi thekson:-** me shefat e grupeve parlamentare kemi biseduar për një vizitë studimore në Shqipëri dhe jemi dakorduar me udhëtar me datë 07.06.2019 dhe me u kthyer me datë 09.06.2019. Me shefat e grupeve parlamentare u dakordua që në vizitë me marr pjesë edhe ekzekutivi i komunës dhe stafi mbështetës i kuvendit të komunës. Në takim me shefat e grupeve parlamentare është propozuar që në vitin e ardhshëm me shkuar shëndetësia dhe stafi civil i komunës pasi që në këtë vit stafi i arsimit ishte në vizitë në Shqipëri. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Besarta Suma thekson:-** a ka ende mbetje të azbestit për gjatë lumbit Lepenc? Vitin e kaluar kemi diskutuar në kuvend për ndotjen e ajrit nga kompania “Sharrcem” dhe sa ka pas ndikim dhe rezultat ajo çka kemi diskutuar në kuvend sepse ende shihet që ka ndotje gjatë natës.

**Florim Shkreta thekson:-** në tabelën e njoftime ishte një thirrje për aplikim në subvencione në bujqësi dhe nuk kishin planifikuar subvencione për bletari dhe kërkoj sqarim. Te oborri i Shtëpisë së Kulturës nuk e di se a ka marr pëllqim dhe a paguan taksë organeve komunale autoshkolla e cila po i ushtron kadetët fillestarë në prezencë të fëmijëve.

**Sabrije Krasniçi thekson:-** te rruga e “Të Pérndjekurve” dy shtëpitë e vjetrat të cilat ishin dhe sipas informacioneve që kam njëra është rrënuar prej banorëve të cilët banojnë aty afër dhe kishte mbutur ashtu siç e kanë lënë. Unë mendoj që është rrezik përfëmijët për shkak se pasi është rrënuar duhet të largohet krejt. Aksioni “Ta pastrojmë Kosovën” ka qenë por te hekurudha nuk ishte pastruar . Drejtoria e Arsimit a është interesuar për studentët të cilët udhëtojnë për provime me autobusë të Shkupit dhe shumica e autobusëve probleme kanë pasur me autobusët e “Elitës” .

**Sabedin Hasallari thekson:-** lagjja jonë kemi hyrë në pagesë për shfrytëzimin e ujit por kompania “Bifurkacioni” a ka ndonjë referencë që na i ka sjellë tarifat e ujësjellësit për shkak se janë shumë të larta. Për një ekonomi familjare fatura me ardhur 20 €, 25 € apo 30 € është e lartë. Po që se bëhet llogaritje  $0.70 \text{ €}$  një kubik ujë kushton për me paguar . A ka kjo kompani ndonjë bashkëpunim me komunën apo tarifat i kanë përcaktuar vetë sepse po të shikohet në realitet duket se është pak e tepërt dhe ky shqetësim nuk është vetëm i familjes sime por ka ankesa edhe nga banorët e tjerë.

**Kryesuesi thekson:-** informacionin më saktë mund ta merrni nga kompania por unë mendoj se tarifa është regionale.

**Mallzum Qajani thekson:-** çmimi është në nivel të Kosovës për shkak se komisioni rregullativ i rregullon këto çmime dhe ne nuk mundemi me ndërhyrë në këtë punë.

**Zaim Bela thekson:-** buxheti është i vogël për subvencione dhe kur është analizuar numri i bletëve që është 1300 koshere që kanë aplikuar në vitin e kaluar nuk na mjaftojnë mjetet. Bletarët subvencionohen nga pagesat direkte prej Ministrisë së Bujqësisë

**Menduh Vlashi thekson:-** transporti publik është shqetësim edhe i joni por këtë çështje e rregullon Ministria përkatëse për shkak se kompanitë marrin leje për vijat të cilat i mbajnë. Kryetari i komunës ka parashtruar kërkesë që me pas një vijë edhe në Han të Elezit por i marrin vijat dhe nuk vijnë.

**Nexhmedin Daci thekson:-** mbetje të azbestit ka afër lumbit Lepnc. Në vitin 2014 Ministria e Planifikimit Hapësinorë ka pasur një tender të cilin e ka marr një kompani, mirëpo ajo kompani nuk i ka kryer punët mirë. Vitin e kaluar ishin inspektorët e ministrisë dhe ia kanë ndërprerë punimet por me sa jam në dieni janë në proces gjyqisë për këtë çështje. Ministria ka premtuar që ka me na ndihmuar në ndërtimin e fushës së futbollit dhe rregullimin e lumbit Lepenc dhe gjatë rregullimit të shtratit mbetjet do të largohen. Çështja e ndotjes nga kompania "Sharrcem" është kompetencë e Ministrisë dhe ne në dy raste ju kemi drejtuar me shkrim por nuk jemi të kënaqur për shkak se nuk kanë ndërmarr asgjë.

**Besarta Suma thekson:-** Ministria e Ambientit që i ka bërë vlerat shënon në fund se nuk i ka kaluar vlerat e lejuar, mirëpo në fakt ajo o ka kaluar për shkak se vërehet. Përpos atij matësi duhet të vendosen edhe dy matës të tjerë në afërsi të fabrikës te lagja e Vlashëve dhe te lagija e Bardhve për shkak se janë pjesët më të ndotura. Ndërtesa e z.Rexhep Luri ka banorë të cilët potencojnë që nuk mundemi me i qitë jashtë rrobat sepse me një herë bëhen bardh prej pluhurit. Kompania "Sharrcem" ka bërë investim në bimë por bimët nuk rriten ndërsa kompania potencon që ka bërë investim. Unë mendoj që filtri është baza kryesore që duhet me u ndërruar. Komuna duhet t'i bënë kërkesë "Sharrcemit" që të bëhet ndërrimi filtereve dhe të pajisen me filtër më të sofistikuar.

**Nexhmedin Daci thekson:-** kompania ka investuar por ata kanë leje të integruar mjedisore që edhe pse kanë bërë investime nuk ka përfunduar gjithçka rrëth ndotjes për shkak se problem më të madh e kanë hallën e klinkerit. Janë duke i mbajtur retromaterialet në ambient të hapur që nuk kanë të drejtë. Vitin e kaluar ndotjen më të madhe e kemi pasur nga kompania "Bektelenka". Matjen e ndotjes e bëjnë te mullitë, te furra dhe aty me standarde janë shumë mirë por prej hallës së klinkerit del pluhuri gjatë ngarkimit dhe shkarkimit të kamionëve ka ndotje. Objekti i hekurudhës është rrënuar nga komuna, mirëpo kemi pasur problem me hekurudhën sepse ato e kanë trajtuar si pronë të tyre dhe kanë kundërshtuar se pse e kemi rrënuar. Sa i përket aksionit të pastrimit me sa e di unë mirë ka qenë dhe e di se në gjitha anët është pastruar. Sa i përket parkingut që e shfrytëzon auto shkolla Drejtoria e Urbanizmit i ka dhënë pëlqim por jo në shfrytëzim të përhershëm sepse tjetër kund në Han të Elezit nuk ka vend që me u dhënë pëlqim për ushtrim të kandidatëve.


**Florim Shkreta thekson:-** drejtori potenco që matësit për ndotjen e ambientit të cilët janë të vendosur brenda kompanisë "Sharrcem" ndotjen e ajrit e paraqesin që është mirë por nuk është mirë sepse edhe ti si drejtor e din që ata i rregullojnë vetë kur i publikojnë rezultatet. Kjo çështje është problem i të gjithë neve dhe duhet të marrim masa. Ndotjen të cilën e ka bërë kompania "Bektelenka" kohët e fundit është ndotje krejt tjetër. Parkingut është dashur me i qitë kritere dhe sigurimi duhet të jetë më nivel te parkingu i kompanisë "Sharrcem". Drejtori për bujqësi në pyetjen që ja parashtrova potencon që nuk ka pasur mjete financiare dhe me sa mundem me kuptuar drejtori për bujqësi subvencionet ja ka dhënë vetës dhe kjo është bërë një dukuri e shpeshtë për shkak se në Han të Elezit çdo subvencion që epet nga komuna apo shoqatat e ndryshme është e pamundur pa përfituar zyrtarët komunal pavarësisht se në çfarë mënyra. Është mirë që këto gjëra mos me i praktikuar sepse janë gjëra të ulëta. Çështja e ushtrimit të kandidatëve paraqet rrezik për fëmijë dhe mund të ndodhë ndonjë fatkeqësi që mund të lëndohet ndonjë fëmijë sepse kadetët janë fillestarë.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:41

Procesmbajtësi

Avni Bushi





Kryesuesi Kuvendit

MSc. Qamush Brava